

VENDIM
Nr.10, datë 4.1.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHETËTËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS BALLABAN, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shetëtare, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Ballaban, të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shetëtare, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Ballaban, të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.141, datë 8.3.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shetëtare në komunën Ballaban, të qarkut të Gjirokastrës”.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Ballaban për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha